

**NJOFTIM PËR KONTRAKTIMIN E EKSPERTËVE TË JASHTËM**

Kontrolli i Lartë i Shtetit bazuar në nenet 25 dhe 40 të Ligjit Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-it (nr. 1, 10, 11, 12, 20, 21, 30, 40, 100, 200, 240, 300, 400, 1220, 1240, 1620, 3000-3100, 4000-4200, 5000, 5110, 5210, 5230, 5510, 5530 dhe 5600); si dhe Vendimin nr. 61, datë 09.05.2015 të Kryetarit të KLSH-së “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës së ekspertëve të përkohshëm të jashtëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76/2015); shpall procedurat për kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për një periudhë 3 mujore.

Kërkesat për kandidatët ekspert i jashtëm:

- Të jenë diplomuar në ekonomi;
- Të jenë gazetarë aktivë në çështjet ekonomike;

Përshkrimi i punës

Ekspertët e jashtëm të kontraktuar nga KLSH, do të angazhohen në:

- këshillimin e grupeve të auditimit apo strukturave të tjera organizative të KLSH-së, pjesë e procesit të hartimit të Buxhetit Faktik;
- dhënien e ekspertizës në përmirësimin e Udhëzuesit Standart për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit Faktik;

Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në KLSH, deri më datë 04.09.2019 dosjen e tyre personale, e cila duhet të përmbajë këto dokumente:

- Curriculum Vitae;
- Kopje të diplomës së shkollës së lartë, të kualifikimeve pasuniversitare dhe gradave shkencore;
- Kopje të librezës së punës;
- Dokumente të tjera (nëse ka), që çmohen se shërbejnë në vlerësim e tij/saj.

Konkurrimi

Procedurat e konkurrimit dhe shpalljes së fituesve, do të bazohen në përcaktimet e bëra në Vendimin nr. 61, datë 09.05.2015 të Kryetarit të KLSH-së “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës së ekspertëve të përkohshëm të jashtëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76/2015).

Kontrolli i Lartë i Shtetit